



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr. 166/18

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje z Blerim Dina.– Kryetar, Nuhi Paçarizi, - Referues, z.- Goran Milenković Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: “Joos&Krasniqi-Bazë-sh.p.k Junik, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë OE-“Lika Trade”sh.p.k lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Sanimi-Ndërtimi i rrugëve me asfalt” me nr. prokurimi: 632/17/5481/521, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) “KK-Gjakovë” më datën 16.05.2018 mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET si pjesërisht e bazuar ankesa e operatorit ekonomik “Joos&Krasniqi-Bazë-sh.p.k Junik lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Sanimi-Nërtimi i rrugëve me asfalt” me nr. prokurimi: 632/17/5481/521 iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) “KK-Gjakovë”

II. VËRTETOHET, njoftimi për dhënie të kontratës i AK -së “KK-Gjakovë” lidhur me aktivitetin të prokurimit me titull: “Sanimi-Nërtimi i rrugëve me asfalt” me nr. prokurimi: 632/17/5481/521.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues “Joos&Krasniqi-Bazë-sh.p.k Junik, aprovohet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Njoftimi për kontratë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit është bërë me dt: 27.12.2017

Hapja e ofertave është bërë me dt: 16.01.2018

Njoftimi për dhënie të kontratës nga Autoritet Kontraktues, lidhur me këtë aktivitetit të prokurimit është bërë me dt: 26.03.2018, ku është rekomanduar për kontratë OE- -“Lika Trade”sh.p.k .

Kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me këtë aktivitetit të prokurimit, operatori ekonomik “Joos&Krasniqi-Bazë-sh.p.k-Junik, me dt: 10.04.2018 ka bërë kërkesë për rishqyrtim tek autoriteti kontraktues.

Autoriteti Kontraktues me datën 12.04.2018 ka marrë vendim që të refuzohet kërkesa për rishqyrtim e OE “Joos&Krasniqi-Bazë-sh.p.k Junik si të pa bazuar.

Operatori ekonomik ankues “Joos&Krasniqi-Bazë-sh.p.k Junik si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP, me 23.04.2018 me nr. 166 / 18, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Sanimi-Nërtimi i rrugëve me asfalt” me nr. prokurimi: 632/17/5481/521 të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) "KK-Gjakovë” duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1,7,59,56,60,61 dhe neni 70 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 25.04.2018 ka autorizuar ekspertin shqyrtues profesional të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti Shqyrtues në raportin e dt: 30.04.2018, lidhur me pretendimin ankimor të OE ankues "Joos&Krasniqi-Bazë-sh.p.k Junik se ka pasur shkelje të LPP gjegjësisht nenit 1,7,59,56,60,61 dhe neni 70 dhe në finalizim të analizimit dhe shqyrtimit të këtij aktiviteti të prokurimit, konstaton si në vijim:

Lidhur me pretendimin e OE ankues, sa i përket eliminimit nga gara të OE ankues në lidhje me çmimet jo-normalisht të ulëta, lidhur me nenin 61 të LPP-së.

Eksperti shqyrtues vlerëson se NUK qëndron pretendimi ankimor në lidhje me nenin 61 të LPP-së, lidhur me çmimet e ofruar nga OE ankues, për faktin se Autoriteti kontraktues në harmoni me nenin 61 të LPP-së, ka kërkuar sqarime shtesë në lidhje me çmimet e OE ankues ku i njëjti ka ofruar çmime jo-normalisht të ulëta në shumicën e pozicioneve konkretisht në 21 pozicione ka ofruar çmime prej 0.01€, ndërsa vetëm në 6 pozicione në Panamasë ka ofruar çmime në harmoni me tregun, ku kanë qenë të pranueshëm nga komisioni vlerësues.

Eksperti shqyrtues bazuar në nenin 61 të LPP-së, vlerëson se AK-ja në harmoni me nenin 61, paragrafi 1 ka kërkuar nga ana e OE ankues me dt.26.01.2018 sqarim në lidhje me çmimet jo-normalisht të ulëta, dhe pas sqarimit të marr nga ana e OE ankues në harmoni me paragrafin 4 të nenit 61, ka bërë refuzimin e ofertës të OE ankues. Eksperti shqyrtues sqaron se oferta e OE ankues është mbi 100% me çmime më të ulët në krahasim me ofertuesit tjerë pjesëmarrës, njehërit vlerësoj se ekzaminimi dhe vlerësimi i çmimeve është e drejtë ekskluzive e Autoritetit kontraktues.

Eksperti shqyrtues vlerëson se AK-ja ka vepruar në harmoni me nenin 59 dhe 61 të LPP-së, gjatë vlerësimit të ofertës së OE ankues pasi që i njëjti ishte i papërgjegjshëm në bazë të ofertes financiare, konkretisht OE ankues ka vendosur çmime jo-normalisht të ulëta për këtë aktivitet të prokurimit.

Lidhur me pretendimin e OE ankues, sa i përket përgjegjshmërisë së ofertës të OE Lika Trade shpk, i rekomanduar për kontratë nga ana e komisionit ri-vlerësimit,

Eksperti shqyrtues vlerëson se NUK qëndron pretendimi ankimor në lidhje me formularin e tenderit të plotësuar nga ana e OE të rekomanduar për kontratë sepse formulari i tenderit është plotësuar në harmoni me nenin 32.2 të RRUOPP.

Eksperti shqyrtues vlerëson se NUK qëndron pretendimi ankimor sa i përket Certificate për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë ISO 9001:2008 (kopje), për faktin se OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar Certificate për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë ISO 9001:2015 (kopje) në emër të OE Lika Trade, data e publikimit cert.10.06.2016, me nr, certifikatës KC172223.

Eksperti shqyrtues vlerëson se NUK qëndron pretendimi ankimor në lidhje me ofertën e OE të rekomanduar për kontratë sa i përket deklaratës me shkrim për stafin profesional për angazhim në këtë projekt, për faktin se në dosjen e tenderit është kërkuar: Listën e kualifikimeve shkollore dhe profesionale të personelit tuaj udhëheqës dhe fuqisë tjetër punëtore. Nëse anëtarët e stafit nuk janë në marrëdhënie pune te Operatori Ekonomik, atëherë duhet dorëzuar kontratën për projektin në fjalë (të dëshmohet me një Deklaratë që Operatori Ekonomik i ka të punësuar ose mund ti angazhoj staf për kryerjen e punëve me sukses, e vulosur dhe nënshkruar nga Operatori Ekonomik), ndërsa OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar staf Professional të cilët janë të angazhuar në kompani (marrëdhënie pune) ku janë të shënuar në kontratat e punës data e fillimit të punës, ndërsa sa i përket deklaratës së kërkuar vlen vetëm për anëtarët e stafit të cilët nuk janë në marrëdhënien punë te OE.

Eksperti shqyrtues vlerëson se NUK qëndron pretendimi ankimor në lidhje me ofertën e OE të rekomanduar për kontratë sa i përket pretendimit ankimor të parashtruar nga OE ankues ku thuhet: Identifikimi financiar i paraqitur nga OE Lika Trade është pa titull të aktivitetit të prokurimit dhe pa nr. prokurimit, kjo NUK qëndron sepse në identifikimin financiar askund nuk është kërkuar vendosja e aktivitetit të prokurimit si dhe nr. prokurimit, identifikimi financiar shërben vetëm për mbajtësin e llogaris dhe Banka, por ja vlen të theksohet se ky dokument nuk kryen funksionin (vlerësues) për një aktivitet të prokurimit.

Eksperti shqyrtues në lidhje me ankesën e parashtruar nga OE ankues vlerëson se Prezantimet procedurale për deponimin e ankesës pranë OSHP-së janë të parapara në nenin 111.par.1 pika 1.5 dhe 1.8 të LPP-së, janë të caktuara në mënyrë kumulative, që nënkupton se ankuesi duhet të dëshmojë interesin juridik për marrjen e kontratës konkrete në prokurim publik, si dhe shkaktimin e dëmit material për shkak të shkeljes së të drejtave të tij subjektive. Në rastin konkret duhet theksuar se ankuesi në ankesën e tij e konteston ofertën e fituesit dhe OE të tjerë pjesëmarrës, por oferta financiare OE ankues është shpallur e përgjegjshme në bazë të nenit 61 të LPP-së. Nga kjo rezulton se aprovimi eventuale i pretendimeve të tija ankimore nuk do të rezultonte me përzgjedhjen e ofertës së tij dhe me lidhjen e kontratës në prokurim publik, dhe se ankuesit në rastin konkret nuk i është shkaktuar dhe as nuk do të mund të i shkaktohet dëm, e që është prezumim për parashtrim të ankesës konform nenit 111.par. 1, pika 1.8 të LPP-së, sepse i njëjti në asnjë rrethanë nuk mundet të jetë fitues i kontratës edhe nëse ky aktivitet kthehet në ri-vlerësim.

Eksperti shqyrtues duke u bazuar në atë se pretendimet ankimore në lidhje me OE fitues janë të

paqëndrueshme, dhe i njëjti OE fitues ka ofruar çmimin më të ulët dhe ofertë të përgjegjshme në krahasim me OE tjerë pjesëmarrës, vlerëson se pretendimet ankimore të parashtruar nga OE ankues në lidhje me ofertat OE të renditur me çmim më lartë se OE fitues nuk mundet të ndryshojnë rezultatin përfundimtar në këtë aktivitet të prokurimit

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të refuzoj si të pa-bazuar (për arsyen që u cek tek përgjigja në pretendimet e lartë cekura), njëherit rekomandoj që ky aktivitet i prokurimit të vazhdoj më tutje, në harmoni me legjislacionin për prokurim publik

Operatori Ekonomik ankues përmes parashtresës me shkrim të datës: 30.04.2018, ka njoftuar Panelin shqyrtues se nuk pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Autoriteti kontraktues përmes parashtresës me shkrim të datës: 30.04.2018, ka njoftuar Panelin shqyrtues se pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 16.05.2018, ku kanë qenë prezent paneli shqyrtuesi , përfaqësuesi i OE ankues dhe përfaqësuesi i Autoriteti Kontraktues, u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi mbi dhënien e kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE ankues z. Krasniqi deklaroi: Ne kemi qenë ofertues në këtë projekt, jemi shpall të papërgjegjshëm për shkak çmimit jo normalisht të ulët, dhe lënda është kthyer në rivlerësim, prapë AK shpall një OE fitues i cili është i papërgjegjshëm OE: "Lika Trade". Në dosje të tenderit është kërkuar ISO 9001:2008 , të cilin standard nuk e ka ky OE, po ashtu i mungon deklaratë me shkrim që këtë staf profesional të punëtorëve mund ta angazhoj për këtë projekt që ka iniciuar AK-KK Gjakovë, pjesën C nuk e ka të mbushur komplet një faqe, identifikimi financiar i paraqitur nga OE i mungon titulli projektit dhe numri i prokurimit.

Përveç nesh në këtë aktivitet të prokurimit asnjë OE nuk është i përgjegjshëm, dhe sa i përket çmimit normalisht të ulët, ne posedojmë bazën e asfaltit, fabrikën e gypave dhe gurthyes andaj çmimi jonë është më i ulët. Po ashtu katër vitet e fundit kemi punuar me po këto çmime të njëjta.

Dëmet tona janë shumë të mëdha dhe të pariparueshme pasi jemi përgatitur për kryerjen e këtyre punëve .Për katër vite nuk kemi pas vërejtje në punën tonë nga AK-KK Gjakovë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i AK-së znj. Bakalli deklaroj: Herën e parë kur është kthyer lënda në rivlerësim, arsyeja ka qenë pse nuk i kemi dhënë qasje në dokumente zyrtare me vonesë pas dy dite. Sa i përket OE të rekomanduar për kontratë i njëjti është i përgjegjshëm dhe këtë ka konstatuar edhe eksperti. ISO standardet ISO 9001:2008 dhe ISO 9001:2015 janë i njëjti standard, me dallimin që ISO 2015 është i më i ri dhe i lëshohet OE-ve që ju ka kalon afati për atë të vitit 2008. Ne mbështesim raportin e ekspertizës që për herë të dytë mbështet vendimin e AK dhe OE ankues nuk ka as interes material juridik në këtë procedurë. OE fitues i plotëson gjitha kërkesat minimale të kërkuara me dosje të tenderit dhe i njëjti siç ceka më lart është i përgjegjshëm. Kërkojmë nga panelit shqyrtues që njoftimin për dhënie të kontratës të AK ta aprovoj sa më shpejtë që është e mundshme.

Në fjalë përfundimtare përfaqësuesi i OE z.Krasniqi deklaroj: Sa i përket ISO Standardit, është kërkuar ISO 9001:2008, dhe nuk është kërkuar 9001:2015. Përveç kësaj i mungon deklaratë për angazhimin e punëtorëve në projektin e caktuar nga AK. Ne qëndrojmë pranë çmimeve të dhëna ne oferta. I propozojmë panelit shqyrtues të aprovoj ankesën tonë si të bazuar dhe lënda të kthehet në Rivlerësim konform dispozitave të LPP pranë AK-së.

Në fjalë përfundimtare përfaqësuesi i AK-së znj. Bakalli deklaroj: Qëndrojmë pranë vendimit të AK-së dhe i propozojmë panelit që të vërtetoj vendimin e AK-së si të bazuar dhe të refuzohet ankesa e OE ankues.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pikave pretenduese të parashtruesit të ankesës, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues/porfesional, deklaramit te palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, konstaton se sa i përket pretendimit te OE ankues, se autoriteti kontraktues ka vepruar ne kundërshtim me nenin 61 të LPP-së , lidhur me eliminimin e tij nga pjesëmarrja në këtë aktivitet të prokurimit, paneli konstaton se ky pretendim është i pa qëndrueshëm për faktin se autoriteti kontraktues në harmoni me nenin 61 të LPP-së, ka kërkuar sqarime shtesë në lidhje me çmimet e OE

ankues ku i njëjti ka ofruar çmime jo-normalisht të ulëta në shumicën e pozicioneve konkretisht në 21 pozicione ka ofruar çmime prej 0.01€, ndërsa vetëm në 6 pozicione në panamasë ka ofruar çmime në harmoni me tregun, ku kanë qenë të pranueshëm nga komisioni vlerësues. Prandaj duke u nisur në të cekurat si më lart paneli shqyrtues konstaton se bazuar në nenin 61 të LPP-së, vlerëson se AK-ja, në harmoni me nenin 61, paragrafi 1 ka kërkuar nga ana e OE ankues me dt.26.01.2018 sqarim në lidhje me çmimet jo-normalisht të ulëta, dhe pas sqarimit të marr nga ana OE ankues në harmoni me paragrafin 4 të nenit 61, ka bërë refuzimin e ofertës të OE ankues, po ashtu duhet theksuar se oferta e OE ankues është mbi 100% me çmime më të ulët në krahasim me ofertuesit tjerë pjesëmarrës.

Paneli shqyrtues vlerëson se AK-ja, ka vepruar në harmoni me nenin 59 dhe 61 të LPP-së, gjatë vlerësimit të ofertës së OE ankues pasi që i njëjti ishte i papërgjegjshëm në bazë të ofertës financiare, konkretisht OE ankues ka vendosur çmime jo-normalisht të ulëta për këtë aktivitet të prokurimit.

Paneli shqyrtues konstaton se nuk qëndron pretendimi i OE ankues, sa i përket përgjegjshmërisë se ofertës të OE Lika Trade shpk, OE ky i rekomanduar për kontratë nga ana e komisionit ri-vlerësimit, në lidhje me formularin e tenderit të plotësuar nga ana e OE të rekomanduar për kontratë, është i pa qëndrueshëm ky pretendim për faktin se formulari i tenderit i OE të rekomanduar për dhënie të kontratës është plotësuar në harmoni me nenin 32.2 të RRUOPP.

Paneli shqyrtues konstaton se nuk qëndron pretendimi ankimor lidhur me operatorin ekonomik të rekomanduar për dhënie të kontratës në lidhje me Certifikatën për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë ISO 9001:2008 (kopje), për faktin se OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar Certifikatë për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë ISO 9001:2015 (kopje) në emër të OE Lika Trade, data e publikimit cert.10.06.2016, me nr, certifikatës KC172223.

Paneli shqyrtues konstaton se nuk qëndron pretendimi ankimor në lidhje me ofertën e OE të rekomanduar për kontratë sa i përket deklaratës me shkrim për stafin profesional për angazhim në këtë projekt, për faktin se në dosjen e tenderit është kërkuar: Listën e kualifikimeve shkollore dhe profesionale të personelit tuaj udhëheqës dhe fuqisë tjetër punëtore. Nëse anëtarët e stafit nuk janë në marrëdhënie pune të Operatori Ekonomik, atëherë duhet dorëzuar kontratën për projektin në fjalë (të dëshmohej me një Deklaratë që Operatori Ekonomik i ka të punësuar ose mund ti angazhoj staf për kryerjen e punëve me sukses, e vëlosur dhe nënshkruar nga Operatori Ekonomik), ndërsa OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar staf Professional të cilët janë të angazhuar në kompani (marrëdhënie pune) ku janë të shënuar në

kontratat e punës data e fillimit të punës, ndërsa sa i përket deklaratës së kërkuar vlen vetëm për anëtarët e stafit të cilët nuk janë në marrëdhënien punë te OE.

Paneli shqyrtues konstaton se nuk qëndron pretendimi ankimor në lidhje me ofertën e OE të rekomanduar për kontratë sa i përket pretendimit ankimor të parashtruar nga OE ankues ku thuhet: Identifikimi financiar i paraqitur nga OE Lika Trade është pa titull të aktivitetit të prokurimit dhe pa nr. prokurimit, nuk është i qëndrueshëm ky pretendim sepse në identifikimin financiar askund nuk është kërkuar vendosja e aktivitetit të prokurimit si dhe nr. prokurimit, identifikimi financiar shërben vetëm për mbajtësin e llogaris dhe Banka, por ja vlen të theksohet se ky dokument nuk është kriter matës (vlerësues) për një aktivitet të prokurimit.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në diapozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të vendimit .

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Blerim DINA



Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – "KK Gjakovë

1x1 OE - "Joos&Krasniqi-Bazë-sh.p.k Junik

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së.